

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PaKr 87/13

Data: 27 Mars 2014

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS me Trupin Gjykses të përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it, Philip Kanning si Gjyqtar Kryesues dhe Raportues, dhe Gjyqtarëve pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, Abdullah Ahmetit dhe Tonka Berishës si anëtarë të Panelit, dhe me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it, Andreas Parmas në rolin e Procesmbajtësit, në procedurën penale kundër

U.M., i dënuar nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të **Marrjes së Ryshfetit** nga Neni 343 (1) i Kodit Penal të Kosovës (KPK-së), dhe **Ushtrim të ndikimit** në kundërshtim të Nenit 345 (1) të KPK-së;

V.Z., i dënuar nga gjykata e shkallës së parë për veprën penale të **Dhënies së Ryshfetit** nga Neni 344 (1) i KPK-së, dhe dy akuza të **Ushtrimit të ndikimit** në kundërshtim të Nenit 345 (1) dhe (2) të KPK-së;

Duke vepruar mbi Ankesat e Avokatëve Mbrojtës, Orhan Basha, Mahmut Halimi dhe Enver Nimani të dorëzuara respektivisht më 14, 21 dhe 14 Janar 2013 në emër të të Pandehurit U.M., dhe mbi **Ankesën e Avokatit Mbrojtës, Zeqir Berdyna** e dorëzuar në emër të të Pandehurit V.Z. më 18 Janar 2013, që të gjitha ankesat e paraqitura kundër **Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, nr.P.2668/11 të datës 18 Janar 2012;**

Pasi që është marrë në konsideratë Përgjigjja për Ankesën nga Zyra e Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë e dorëzuar më 23 Janar 2014;

Pasi që është marrë në konsideratë Mendimi i Prokurorit të Apelit pranë Zyrës së Prokurorit të Shtetit, nr. PPA/I.-KTŽ 28/13 i datës 1 Korrik 2013 dhe i dorëzuar po në të njëjtën ditë;

Pasi që është mbajtur një seancë e hapur më 27 Mars 2014, ku të gjitha palët janë thirrur në mënyrë të duhur, në prezencë të Pandehurve U.M. dhe V.Z., të Avokatëve Mbrojtës O. Basha, E. Nimani dhe Z. Berdyna;

Pas këshillimit dhe votimit më 27 Mars 2014,

Në mbështetje të Nenit 420 dhe sipas Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së)

Vendosi si në vijim

AKTVENDIM

- 1. Miratohen ankesat e Avokatëve Mbrojtës, ajo e Mahmut Halimit dhe e Enver Nimanit të parashtruara në emër të të Pandehurit U.M..**

2. Miratohet pjesërisht ankesa e Avokatit Mbrojtës Orhan Basha në emër të të Pandehurit U.M., në lidhje me kundërshtimin e detyrimit të të Pandehurit U.M. për të paguar shumën totale prej 450 Euro si shpenzime të procedurës penale.
3. Miratohet Ankesa e Avokatit Mbrojtës e parashtruar në emër të të Pandehurit V.Z..
4. Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës i datës 18 Janar 2012 në lidhje me lëndën penale me nr. P 2668/11.
5. Refuzohen akuzat kundër të Pandehurit V.Z..
6. Lënda dërgohet tek Gjykata Themelore e Prishtinës për ri-gjykim për sa i përket akuzave kundër të Akuzuarit U.M..

ARSYETIMI

I. Historia procedurale e lëndës

1. Më 4 Nëntor 2010, Prokurori Publik dorëzoi Aktakuzën PP 1111/2008 pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës, kundër të Pandehurve U.M. dhe V.Z., duke akuzuar U.M. për dy pika të veprës penale të Marrjes së ryshfetit sipas Nenit 343 (1) të KPK-së dhe V.Z. për dy pika të veprave penale të Dhënies së ryshfetit në shkelje të Nenit 344(1) të KPK-së dhe atë të Mashtrimit në kundërshtim me Nenin 261 (1) i KPK-së.
2. Shqyrtimi kryesor është mbajtur ndërmjet datës 21 Nëntor 2011 dhe 18 Janar 2012, ku është shpallur edhe aktgjykimi.
3. U.M. u dënua për veprën penale të Marrjes së ryshfetit sipas Nenit 343 (1) të KPK-së, dhe atë të Ushtrimit të ndikimit në kundërshtim me Nenin 345 (1) të KPK-së. Atij iu shqiptua respektivisht një dënim me burg prej 2 vjet dhe 6 muaj dhe 1 vit. Dënimi unik prej 3 vjetësh burg iu shqiptua. Si dënim plotësues, U.M. ishte ndaluar për të ushtruar funksione në administratën publike për 3 vjet. Sipas Nenit 343 (4) të KPK-së, shumata prej 10 000 Euro, përfitim i ryshfetit, u urdhërua që të konfiskohet.
4. V.Z. u dënua për veprën penale të Dhënies së ryshfetit sipas Nenit 344 (1) të KPK-së, të veprës penale të Ushtrimit të ndikimit në kundërshtim me Nenin 345 (1) të KPK-së dhe të Ushtrimit të ndikimit në shkelje të Nenit 345 (2) të KPK-së. Ai, respektivisht u dënua me 1 vit e 6 muaj burg, 1 vit dhe për 6 muaj respektivisht. Dënimi unik u përcaktua për dy vjet burg. Si dënim plotësues, V.Z. ishte ndaluar për të ushtruar funksione në administratën publike për një periudhë kohore prej 2 vjetësh.
5. Gjykata e Shkallës së Parë konstatoi, duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarit të dhënë gjatë fazës së procedurës paraprake, se F.N. i ka dhënë 10 000 Euro V.Z.t që t'ia dërgonte Gjyqtarit U.M. si pagesë për të, që të ndërhynte në favor të Driton dhe P.N., të cilët ishin mbajtur në paraburgim. Gjithashtu, Gjykata ka konstatuar se P.N. i ka dhënë edhe një shumë tjetër prej 1000 Euro V.Z.t, me qëllim që të ndihmohej për ankesën kundër dënimit të lëshuar nga Trupi Gjykses i kryesuar nga Gjyqtar U.M..

Përveç kësaj, Gjykata ka konstatuar se P.N. i ka dhënë 100 Euro Gjyqtarit U.M., me qëllim që ai të ndërhynte tek trupi gjykues në lidhje me shqiptimin e lirimit me kusht kundrejt P.N., ndërsa V.Z. ka vepruar si ndërmjetës i këtyre negociatave.

6. Gjykata e Qarkut konstatoi se versioni i ndryshëm i ngjarjeve të paraqitura nga dëshmitarët gjatë shqyrtimit kryesor nuk ishte i besueshëm.
7. Trupi Gjykues theksoi se deklaratat e dhëna nga A.N. gjatë hetimit janë prova të pranueshme, pavarësisht faktit që mbrojtja nuk ka patur mundësi që të sfidoj atë gjatë ndonjë faze të procedurës penale. Gjykata e Shkallës së Parë e vlerësoi këtë qasje të lejueshme në bazë të Nenit 368 (1) të KPPK-së, meqenëse paraqitja e A.N. para gjykatës ishte e pamundur sepse vendndodhja e tij nuk dihej nga ana e Gjykatës. Në të njëjtën kohë, edhe Gjykata e Shkallës së Parë theksoi se në bazë të Nenit 157 (2) të KPPK-së, të Pandehurit nuk janë shpallur fajtor duke u bazuar vetëm në dëshminë e dhënë nga A.N.
8. Gjykata e Shkallës së Parë konstatoi se akuzat e marrjes së ryshfetit kundër U.M. në episodin e 1 Nëntorit 2008, dhe ajo e mashtrimit dhe dhënie ryshfeti kundër V.Z., respektivisht në episodin e Janarit 2007 dhe të 1 Nëntor 2008, janë gabim për sa i përket aplikimit të ligjit material penal. Prandaj, Gjykata i ka ri-kualifikuar këto episode.
9. Gjykata theksoi se nuk ka asnjë provë që U.M. ka kryer ndonjë akt brenda fushëveprimit të autoritetit të tij në lidhje me episodin e mësipërm. Ai vetëm kishte premtuar që të ushtronte ndikim mbi procesin e vendim marrjes së lirimit me kusht të P.N.. Një akt i tillë do të korrespondonte më shumë me përshkrimin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit, sesa me marrjen e ryshfetit. Nën të njëjtën frymë, V.Z., kur ka marrë 1000 Euro nga dëshmitari P.N., ishte për të ushtruar ndikimin e tij mbi procesin e vendim marrjes në lidhje me ankesën kundër Aktgjykimit që dënonte P.N. (nr. P 474/06 i GjQ të Pejës). Prandaj, marrja e të hollave nuk mund të jetë treguese për veprën penale të mashtrimit, por për veprën penale të ushtrimit të ndikimit. Gjithashtu, kur ka vepruar si ndërmjetës në dhënien e mëtejshme të 100 Euro U.M.t, në emër të P.N., ai po ushtronte ndikim mbi procesin e vendim marrjes në lidhje me lirimin me kusht të P.N., që korrespondon me anën objektive të veprës penale të ushtrimit të ndikimit.

II. Parashtrësasat e palëve

1. Ankesat

10. Avokati Mbrojtës O. Basha në emër të të Pandehurit U.M. i propozon Gjykatës së Apelit që të modifikoj Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, në mënyrë që U.M. të lirohet nga vepra penale e marrjes së ryshfetit dhe që Aktakuza të refuzohet për sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit, për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit. Përndryshe Avokati Mbrojtës kërkon që lënda të kthehet për ri-gjykim tek Gjykata e Qarkut para një Trupi Gjykues të ri.
- 10.1. Ankuesi parashtron se e drejta penale materiale është shkelur në lëndën aktuale, sepse konfiskimi nuk është i bazuar në Aktgjykim. As provat nuk tregojnë që U.M. pretendohet të ketë marrë para ryshfeti. Ndjekja penale për sa i përket veprës penale të

ushtrimit të ndikimit pushohet për shkak të parashkrimit sipas Nenit 90 (1.6) të KPK-së.

- 10.2. Aktgjykimit të Sfiduar i mungon arsyetimi dhe nuk përmban analizë mbi provat kundërtënëse. Aktgjykimi është bazuar në prova të papranueshme, të cilat vazhdimisht janë sfiduar nga Avokati Mbrojtës. Sigurimi i provave vazhdoi edhe pas marrjes në pyetje të U.M., ndërsa Bashkë i akuzuari V.Z. nuk është intervistuar asnjëherë nga ana e Prokurorit. E drejta për të kundërshtuar provat u ishte mohuar të akuzuarve nga Prokurori.
- 10.3. Dispozitivi i Aktgjykimit është i paqartë, në kundërshtim me vetveten dhe me arsyetimin, Aktgjykimit i mungon arsyetimi në faktet vendimtare, dhe arsyetimi bie në kundërshtim me përmbajtjen e provave. Avokati Mbrojtës, gjithashtu thekson se Aktgjykimi nuk ka analizuar të gjitha provat, d.m.th. dëshminë e dëshmitarit P.N. dhe atë të P.G., deklaratën e A.N. të shkruar me dorë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës më 1 Mars 2007, deklaratat e dëshmitarëve Z.S., S.B., I.T. Në asnjë vend të Aktgjykimit të Sfiduar nuk është përcaktuar koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së veprës penale të krijuar.
- 10.4. Pasi që Aktakuza fillestare iu kthye Prokurorit, Prokurori nuk ka respektuar Nenin 306 (2) dhe Nenin 305 (1.5) të KPPK-së, duke dorëzuar “aktakuzën e dytë” në shkelje të afateve të parapara kohore. Hetimi, në shkelje të Nenit 225 (1) të KPPK-së, ka zgjatur më pak se sa gjashtë muaj, ndërsa pas skadimit të peridhës hetimore, Prokurori nuk ka argumentuar komplikimin e lëndës në kërkesën e tij për vazhdimin e hetimit.
- 10.5. Ankuesi pohon se procesverbalet e seancave të gjykimit nuk janë finalizuar në fund të secilës seancë; prandaj mbrojtja asnjëherë nuk mund të ushtronte të drejtën e saj për të komentuar në saktësinë e shënimeve të shqyrtimit kryesor. Ai parashtrohet se shënimet e shqyrtimit kryesor nuk janë në përputhje me Nenin 351 (3) të KPPK-së, meqenëse procesverbalet nuk reflektojnë momentet prekëse të seancave të gjykimit. Sipas Avokatit Mbrojtës, pjesë të informacioneve janë hequr nga procesverbalet, dhe sugjeron që të dy Gjyqtarët e EULEX-it në Trupin Gjykses duhet të kishin qenë të përjashtuar, sepse ata kanë punuar më parë së bashku pranë gjykatës së njëjtë me të akuzuarin.
- 10.6. Avokati Mbrojtës thekson se Trupi Gjykses ka mbikëqyrë faktin se Akvendimi për ndërprerjen e paraburgimit të D.N., P.N. dhe L.K. ishte lëshuar nga trupi gjykses, dhe jo individualisht nga i Pandehuri në rolin e Kryetarit të Trupit Gjykses. Trupi Gjykses ka vlerësuar faktet në mënyrë jo të plotë, sepse dëshmitari alibi i propozuar nga ana e të Pandehurit nuk është dëgjuar. Në fakt, Gjykata as që ka vendosur për refuzimin e propozimit. Deklaratat e dëshmitarit nuk mbështesin akuzat kundër U.M..
- 10.7. Për sa i përket dënimit, Avokati Mbrojtës pohon se Gjykata gabimisht nuk i është referuar rrethanave lehtësuese. Ankuesi gjithashtu pohon që nuk ka patur shpenzime të cilat do të kishin justifikuar detyrimin e U.M.t që të paguante shumën e të hollave për rimbursim të shpenzimeve të procedurës.
- 10.8. Së fundi, Ankuesi ngre dyshime nëse Aktgjykimi është nënshkruar nga Kryetari i Trupit Gjykses.

11. Avokati Mbrojtës, Mahmut Halimi propozon që U.M. të lirohet nga akuza e marrjes së ryshfetit. Përndryshe, ai kërkon që lënda të kthehet tek Gjykata e Shkallës së Parë për rigjykim. Si alternativë të tretë, ai propozon që të akuzuarit t'i shqyptohet një dënim më i lehtë. Për sa i përket veprës penale të ushtrimit të ndikimit, Ankuesi propozon që të lirohet për shkak të parashkrimit.
- 11.1. Trupi Gjykues ka shkelur procedurën penale duke lejuar deklaratat e dëshmitarit të dhëna në polici si të pranueshme. Ankuesi parashtron që deklarata e A.N. është e papranueshme dhe nuk duhej që të mbështetej nga Gjykata. Gjithashtu, Aktgjykimi ka shkelur ligjin procedural, sepse provat e siguruara gjatë procedurës paraprake nuk ishin lexuar në shqyrtimin kryesor apo analizuar nga Gjykata.
- 11.2. Aktgjykimit të Sfiduar i mungon arsyetimi.
- 11.3. Ankuesi kritikon procedurat pas refuzimit të “Aktakuzës së parë”, d.m.th. atë të datës 27 Mars 2009, dhe thekson se për një viti e shtatë muaj Prokurori Publik intervistoi dy dëshmitarë, deklaratat e të cilëve nuk janë përdorur në “aktakuzën e dytë”, të datës 4 Nëntor 2011.
- 11.4. Sipas Avokatit Mbrojtës gjendja faktike është konstatuar gabimisht. Deklaratat e dhëna në polici ishin sajuar nga familja N. për t'u hakmarrë kundrejt U.M., për caktimin e dënimit të lartë ndaj D.N., P.N. dhe L.K.. Dëshmitarët vetë kanë pranuar (*p.sh.* P.N.) se ato kishin gënjer për tu hakmarrë. Ekzistojnë mospërputhje në deklarata në detajet vendimtare si për shembull për vendin e banimit të U.M., apo shuma egzakthe e pretenduar e ofruar si ryshfet. Fakti që duhej të përjashtonte të gjithë diskutimin mbi keqpërdorimin e mundshëm të pozitës zyrtare nga i Pandehuri është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili ka refuzuar ankesat e të pandehurve D.N., P.N. dhe L.K., dhe gjithashtu ankesa e Prokurorit Publik dhe konfirmoi Aktgjykimin e trupit gjykues. Si përfundim, Ankuesi parashtron se nuk ka prova shfajësuese dhe si rezultat e drejta penale materiale është aplikuar gabimisht dhe në dëm të të Pandehurit.
- 11.5. Në lidhje me akuzën e ushtrimit të ndikimit, ai argumenton se ndjekjes penale i ka kaluar koha sipas Nenit 90 (1.5) të KPK-së.
- 11.6. Avokati Mbrojtës konstaton se dënimi i shqiptuar për U.M. është shumë i ashpër. Ai përmendë si rrethana lehtësuese se i Pandehuri asnjëherë nuk është shpallur fajtor për vepra penale të ngjashme, ai ka shërbyer si gjyqtar pothuajse për tre dekada, që ai është në një situatë të varfër ekonomike, që ai është sjellë në mënyrë të duhur gjatë procedurës, dhe thekson që një dënim me kusht do të përmbushte më së miri qëllimin e përgjithshëm të dënimit.
12. Avokati Mbrojtës E. Nimani propozon që të liroj U.M. prej të dy akuzave, apo që Aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehen për ri-gjykim para një paneli tjetër.
- 12.1. Ai së pari konstaton se Aktgjykimi i Sfiduar është i pakuptueshëm. Më tej, Ankuesi argumenton se Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur dispozitat e procedurës penale në lidhje me çështjen nëse egziston një akuzë nga një prokuror i autorizuar, duke pohuar se pas refuzimit të “aktakuzës së parë”, përmes Aktvendimit të Gjyqtarit Konfirmues më 17 Nëntor 2009, nuk ishte e mundur për të dorëzuar një aktakuzë të re

për të njëjtën lëndë. Aktgjykimi është bazuar në prova të papranueshme, *d.m.th.* informacione të mbledhura nga policia para se të fillohej hetimi. Përktimi Shqip i Aktgjykimit nuk është nënshkruar nga Kryetari i Trupit Gjykses apo Personeli i Gjykatës, ndërsa nënshkrimi i versionit Anglisht nuk është verifikuar që t'i përkas Kryetarit të Trupit Gjykses i cili është larguar nga Kosova në Janar 2012. Ankuesi konstaton se hedhja poshtë e ankesës së tij kundër konfirmimit të “aktakuzës së dytë” si e papranueshme ka qenë në shkelje të Nenit 317 (2) dhe 431 të KPPK-së.

- 12.2. Avokati Mbrojtës nuk pajtohet me vlerësimin e Trupit Gjykses të deklaratave kontradiktore të dhëna gjatë fazave të ndryshme të procedurës. Ai argumenton se deklarata e V.Z. në polici më 27 Janar 2009, duhej të konsiderohej një deklaratë dëshmitari; prandaj, vlerësimi i Gjykatës është i gabuar sepse pjesëmarrësit nuk mund të mbajnë dy role gjatë një procedure të njëjtë: atë të dëshmitarit dhe të pandehurit.
- 12.3. Gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të gabuar nga Trupi Gjykses sepse alibia e U.M. nuk ishte verifikuar, dhe gjithashtu disa prova nuk janë vlerësuar – si për shembull: deklaratat e P.N.t dhe P.G. të dhëna para Prokurorit, deklarata me shkrim e A.N., Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës më 21 Mars 2007, apo deklarata e V.Z. gjatë seancës dëgjimore për konfirmim.
- 12.4. Detyrimi që i Pandehuri duhej të paguante shpenzimet e procedurës në shumën totale prej 350 Euro është i pa bazë dhe ilegal.
13. Avokati Mbrojtës Z. Berdyna në emër të të Pandehurit V.Z. propozon që procedura penale kundër klientit të tij të pushoj apo që ai të lirohet për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit.
- 13.1. Ankuesi parashtrohet se Aktgjykimi i Sfiduar është i pakuptueshëm, dhe i mungon arsytimi, dhe është në shkelje të normave të procedurës penale, i bazuar në prova që nuk janë administruar gjatë gjykimit por të siguruar nga Policia. Dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët në gjykim nuk janë vlerësuar nga Gjykata.
- 13.2. Avokati Mbrojtës pretendon shkelje të dispozitave të procedurës penale që nga fillimi dhe vazhdimi i hetimit, deri gjatë gjithë procedurës, deri në nënshkrimin e Aktgjykimit të sfiduar. Edhe pse e mbron V.Z.n, Avokati Mbrojtës pohon se Kryetari i Trupit Gjykses duhej të ishte përjashtuar, sepse ai më parë kishte punuar së bashku me Bashkë të Akuzuarin U.M.

2. Përgjigja e Prokurorit

14. Prokurori i EULEX-it pranë Zyrës së Prokurorisë Themelore i është përgjigjur Ankesës, duke konstatuar se ajo është e pabazë, dhe se nuk duhej të çoj në ndonjë modifikim të Aktgjykimit të Sfiduar.

3. Mendimi i Prokurorit të Apelit

15. Prokurori Publik i Apelit i kërkon Gjykatës së Apelit që të miratoj Ankesat e Avokatëve Mbrojtës, të anuloj Aktgjykimin e Sfiduar dhe të kthej lëndën për ri-gjykim në lidhje me akuzat e ngritura kundër U.M., dhe të refuzoj Aktakuzën kundër V.Z.t, për sa i përket

akuzave në lidhje me episodet e Janarit 2007 dhe të 1 Nëntorit 2008, për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit.

16. Prokurori është i mendimit se Trupi Gjykues ka shkelur ligjin procedural kur është mbështetur në deklaratat e procedurës paraprake të dëshmitarit A.N.. Gjykata e Shkallës së Parë nuk ka vepruar me kujdes për të siguruar prezencën e këtij dëshmitari në gjykim. Nuk ekziston asnjë provë që – përveç kontaktit me policinë vendore dhe thirrjen e A.N. nga Kosova – Gjykata në fakt është përpjekur që të thirr atë në Zvicër, përmes rrugëve zyrtare të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Megjithatë pretendimet që deklaratat e dëshmitarëve të marra nga intervistat policore në fazën hetimore paraprake ishin të papranueshme, janë të gabuara. Këto prova janë të pranueshme, sepse në asnjë vend në rregullat e KPPK-së, nuk përjashtojnë mundësinë për të përdorur si prova deklaratat e dhëna në Polici gjatë hetimit në procedurë paraprake.
17. Prokurori i Apelit pajtohet me qëndrimin e Avokatit Mbrojtës E. Nimani, që ankesat e të akuzuarit të paraqitura kundër konfirmimit të aktakuzës janë hedhur poshtë gabimisht si të papranueshme. Megjithatë, Prokurori i Apelit e kundërshton mendimin e Ankuesit se ky fakt ka kontribuar në një aktgjykim të gabuar, duke konstatuar se kjo nuk ka ndikuar në lëshimin e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Me tej, Prokurori i Apelit mendon se ankesa e të pandehurve e paraqitur kundër konfirmimit të Aktakuzës ishte e pabazë, dhe sidoqoftë duhej të kishte qenë refuzuar si jomeritore.
18. Aktgjykimit të Sfiduar i mungon arsyetimi në çështjet e rëndësishme. Disa nga provat nuk janë analizuar fare. Arsyetimi i Aktgjykimit nuk shpreh se cilat fakte janë gjetur të konstatuara nga paneli. Arsyetimi i Aktgjykimit mbështetet në spekulime, sepse nuk ka asnjë provë të mbështetshme që tregon se të hollat e dërguara tek U.M. nga V.Z. ishin ndarë ndërmjet njëri-tjetrit.
19. Prokurori i Apelit parashtron se Prokurori Publik ka vepruar sipas udhëzimeve të marra nga Gjyqtari i Konfirmimit dhe ashtu siç përcakton Neni 46 (1), Neni 47 (1) dhe Neni 304 (1) i KPPK-së, kur është dorëzuar në Gjykatë “Aktakuza e dytë” më 4 Nëntor 2010. Nuk ka asnjë dispozitë në KPPK, që do të përfshinte *res judicata* në Aktvendimin e Gjyqtarit Konfirmues për të hedhur poshtë Aktakuzën për mungesë të dyshimit të mirë-bazuar. Në bazë të ligjit, është detyrë e Prokurorit Publik për të ndjekur rastin, ku pikërisht kjo ka ndodhur me lëndën aktuale. Prokurori Publik do të kishte shkelur procedurën penale nëse ai nuk do të kishte ngritur aktakuzën, pavarësisht që kishte prova fajësuese.
20. Argumentet e Avokatëve Mbrojtës O. Basha dhe Z. Berdyna, që Kryetari i Trupit Gjykues dhe anëtari i trupit gjykues, respektivisht Gjyqtari i EULEX-it, duhej që të përjashtoheshin nga trupi gjykues, nuk janë të bazuara. Pohimi i Avokati Mbrojtës E. Nimani që V.Z. është marrë në pyetje nga Policia më 27 Janar 2009 në cilësinë e dëshmitarit nuk qëndron. Është e qartë nga shënimet e intervistës (“FORMA D1”), që V.Z. ishte udhëzuar nga Policia për të drejtat e të dyshuarit dhe është marrë në intervistë në cilësinë e të dyshuarit.
21. Prokurori i Apelit i tërheq vëmendje faktit që një pjesë e akuzave kundër V.Z. duhen që të refuzohen për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit, ndërsa asnjë nga akuzat në lidhje me U.M. nuk ndikohen nga kjo.

22. Prokurori i Apelit nuk pajtohet për kritikën në lidhje me aplikimin e pretenduar të gabuar të rrethanave lehtësuese, kur është shqiptuar dënimi për U.M.n, dhe konstaton se dënimi i shqiptuar është në përputhje të plotë me normat respektive.
23. Në të njëjtën kohë, Prokurori i Apelit pajtohet me pohimin e Avokatëve Mbrojtës O. Basha dhe E. Nimani, për sa i përket shpenzimeve të procedurës të përcaktuara në një shumë totale. Nuk ka asnjë arsye të dhënë në Aktgjykimin e Sfiduar nëse, apo se çfarë lloj shpenzimesh janë bërë gjatë procedurës penale. Edhe nëse eventualisht shuma e shpenzimeve nuk mund të përcaktohet saktësisht, ajo përsëri duhet që të mbështetet në prova, që në fakt disa shpenzime kanë ndodhur gjatë procedurave.
24. Pohimet e Avokatit Mbrojtës O. Basha, që konfiskimi i shumës së dobisë pasurore nga U.M. është i pa mbështetshëm, dhe në fakt konstatimi nuk mbështetet me asnjë provë që ai bile ka marrë ndonjë të hollë, janë të pabaza. Gjykata e Shkallës së Parë ka konstatuar se U.M. ka marrë një rryshfet në shumën prej 10 000 Euro. Meqenëse Neni (4) i KPK-së përcakton këtë si të detyrueshme për të konfiskuar dhuratat apo ndonjë përfitim tjetër të marrë, urdhri për konfiskim të shumë së përmendur është legal.

III. Konstatimet e Gjykatës së Apelit

Juridiksioni i Gjykatës së Apelit

25. Gjykata e Apelit ka juridiksion për të vendosur mbi Ankesën sipas Nenit 17 dhe 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).
26. Paneli i Gjykatës së Apelit është krijuar sipas Nenit 19 (1) të Ligjit për Gjykatat dhe Nenit 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

Ligji Procedural i aplikuar

27. Ligji procedural penal i aplikuar për lëndën respektive është Kodi (i vjetër) i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-ja), që ka qenë në fuqi deri më 31 Dhjetor 2012.

3. Konstatimet mbi meritat

28. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe të Aktgjykimit të Sfiduar, në përputhje me dispozitat e Nenit 394 të KPP-së, në vlerësimin e pretendimeve të ankuesit, Gjykata e Apelit konstatoi se Ankesat e Avokatëve Mbrojtës O. Basha, E. Nimani dhe Z. Berdyna janë të mirë-bazuara dhe duhen që të miratohen, ndërsa Ankesa e Avokatit Mbrojtës, e M. Halimit duhet që të miratohet pjesërisht. Aktgjykimi i Sfiduar duhet që të anulohet. Lënda duhet që të dërgohet për ri-gjykim dhe ri-konsiderim në lidhje me akuzat kundër U.M., dhe të gjitha akuzat kundër të Pandehurit V.Z. duhen që të hedhen poshtë, për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit.
29. Gjykata e Apelit gjeti që Aktgjykimi i Sfiduar shpalli fajtor të Pandehurin V.Z. për veprat penale: 1) Dhënie Rryshfeti, në kundërshtim me Nenin 344 (1), data e veprës penale më 13/9/2006, (dënimi maksimal deri në tre vjet burg, dhe afati i parashkrimit për

3 vjet sipas Nenit 90 (5)); 2) Ushtrim të Ndikimit, në kundërshtim me Nenin 345 (1), data e veprës penale më 1/2007, (dënimi maksimal me burg deri në dy vjet dhe afati i parashkrimit për 3 vjet sipas Nenit 90 (5)); të gjitha nenet e KPK-së. Ndalimi absolut për ndjekjen penale sipas Nenit 91 (6) është dy herë sa afati i parashkrimit, ose gjashtë apo katër vjet respektivisht nga data e veprës penale. Për shkak se këto tre akuza janë hedhur poshtë, apo refuzuar nën frymën e skadimit të afatit që t'i çonin këto çështje në një përfundim final, Paneli i Apelit nuk e sheh të nevojshme që të vendos për kërkesat e tjera të Avokatit Mbrojtës të të Pandehurit V.Z..

30. Gjykata e Apelit gjeti që Aktgjykimi i Sfiduar ka shpallur të fajshëm të Pandehurin U.M. për veprat penale: 1) Marrje Ryshfeti, në shkelje të Nenit 343 (1), data e veprës penale më 13/09/2006, (dënimi maksimal me burg deri në pesë vjet, dhe afati i parashkrimit për pesë vjet sipas Nenit 90 (5)); të gjitha Nenet e KPK-së. Ndalimi absolut mbi ndjekjen penale sipas Nenit 91 (6) është dyfish i afatit të parashkrimit, ose 10 vjet nga data e veprës penale të Dhënies së Ryshfetit (13/9/2016), dhe gjashtë vjet për Ushtrim të Ndikimit (11/1/2014). Si çështje praktike, ka shumë gjasa që akuza e Ushtrimit të Ndikimit do të përfundoj nga data 1/11/2014, por do të ishte e parakohshme për Gjykatën e Apelit që të hedh poshtë atë në këtë kohë.
31. Paragrafët e ngelur të këtij vendimi kanë të bëjnë vetëm me ankesat e të Pandehurit U.M..
32. Gjykata e Apelit konstaton se shumica e argumenteve të avokatit mbrojtës janë të pa bazë, dhe për shkak se lënda do të dërgohet tek Gjykata e faktit për ri-gjykim, këto kundërshtime nuk do të diskutohen gjatë.
33. Gjykata e Apelit i pranon që të dy mendimet, atë të Prokurorit të Apelit dhe të Avokatit Mbrojtës që Aktgjykimi i Sfiduar është bazuar në prova të papranueshme, pra në deklaratat e A.N. Veçanërisht, Paneli i Apelit thekson se nuk janë bërë përpjekje të mjaftueshme për të detyruar paraqitjen e tij që të dëshmonte në gjykim, dhe po ashtu nuk i është dhënë mundësia avokatit mbrojtës për të sfiduar deklaratat e tij të mëparshme ashtu siç përcaktohet nga Neni 156 (2) i KPPK-së. Nuk ka patur të drejtë konfrontimi, dhe nuk ka ekzistuar ndonjë provë që tregonte se është kërkuar ndihma e përbashkët ndërkombëtare. Prandaj, sipas Nenit 156 (2) të KPPK-së, deklaratat e tij duheshin që të përjashtoheshin nga shkresat e lëndës, dhe nuk duhej që ato të përdroreshin si prova për Aktgjykimin. Gjykata e Apelit konstaton se jo vetëm Neni 368 (1.1) nuk duhej që të aplikohet në këtë lëndë, por dhe Neni 157 (1) i KPPK-së po ashtu.
34. Gjykata e Apelit ka shqyrtuar me kujdes Aktgjykimin e Sfiduar dhe konstaton se dispozitivi është i kuptueshëm dhe është me përmbajtje jo kundërthënëse. Përveç kësaj, ndërsa është gjithmonë e mundur për gjykatën e shqyrtimit për të kërkuar më shumë detaje në lidhje me shpjegimet e gjykatës së faktit për pranimin, zhvlerësimin apo refuzimin e provave të prezantuara gjatë dhënies së dëshmisë, arsyetimi i dhënë nga Trupi Gjykses në këtë lëndë është i detajuar në mënyrë të mjaftueshme, që lejon Gjykatën e Apelit të ndjek rrjedhën logjike të arsyetimit të tyre.
35. Avokati Mbrojtës po ashtu ngre çështje që kanë të bëjnë me shkelje të kodit të procedurës penale gjatë fazave të ndryshme të këtyre procedurave. Asnjë nga këto kundërshtime të ngritura, nuk tregojnë se ka shkelje të konsiderueshme të dispozitave të kodit të procedurës penale që ndikuan, apo që mund të kenë ndikuar në lëshimin e një gjykimi të drejtë dhe të ligjshëm. Në këtë mënyrë, ato refuzohen si të pa baza.

36. Gjykata e Apelit pranon argumentet e Avokatit Mbrojtës që shpenzimet e llogaritura kundër të Pandehurit U.M. nuk janë të detajuara në mënyrë të mjaftueshme nga Trupi Gjykues, dhe si rezultat edhe ato duhet të refuzohen.
37. Në këtë linjë të vendimit të Gjykatës së Apelit për të dërguar lëndën për ri-gjykim, çështja e arsyeshmërisë së dënimit është e dyshimtë.
38. Prandaj është vendosur si në dispozitiv.

Ky Aktgjykim i Arsyetuar, i përgatitur në Anglisht, gjuha e autorizuar, është përfunduar më.... Maj 2014.

Gjyqtari Kryesues

Philip Kanning

Gjyqtar i EULEX-it

Anëtar i Panelit

Anëtar i Panelit

Procesmbajtësi

Abdullah Ahmeti

Tonka Berisha

Andres Parmas

Gjyqtari i GJA të Kosovës

Gjyqtare e GJA të Kosovës

Zyrtari Ligjor i EULEX-it